

# Trusti



FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS

BULETINI TREMUJOR  
NR 57 -- VITI XV -- TM1 2022

# TRUSTORJA

**PERFORMANCA**

PERIUDHA	1 MUAJ	3 MUAJ	VITI AKTUAL	3 VJET	5 VJET	NGA THEMELIMI
REZULTATI	1.20%	-2.67%	-2.67%	14.44%	18.13%	67.62%
BENÇMARKU*	0.44%	4.77%	4.77%	12.20%	15.93%	55.48%

\*Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit sikurse i publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës.

**LËVIZJET MUJORE**

MUAJI	NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË AKSIONIT		KTHIMI BRUTO (MLN)	KTHIMI NETO (MLN)
	STANDARD	KONSERVATIV		
Janar	-2.39%	--	€(55.51)	€(56.25)
Shkurt	-1.47%	+0.07%	€(32.55)	€(33.22)
Mars	1.20%	+0.26%	€27.56	€26.82
<b>Tremujori</b>	<b>-2.67%</b>	<b>+0.36%</b>	<b>€(60.50)</b>	<b>€(62.65)</b>

**KONTRIBUIMI**

	KONTRIBUTET E REJA (MLN)	LLOGARI TË REJA	LLOGARI AKTIVE
Janar	€19.96	2,509	303,854
Shkurt	€17.96	2,997	303,437
Mars	€18.11	2,554	317,803
<b>Tremujori</b>	<b>€56.03</b>	<b>8,060</b>	<b>308,365*</b>

\*mesatarja tremujore

**PENSIONIMET**

	TË PENSIONUAR	SHUMA E TËRHEQUR
Janar	482	€3,439,005
Shkurt	628	€4,523,129
Mars	642	€5,710,049
<b>Tremujori</b>	<b>1,752</b>	<b>€13,672,183</b>

**PËRMBLEDHJE SHIFRASH**

	<b>FUNDI TM1 2022</b>	<b>FUNDI TM4 2021</b>
ÇMIMI I AKSIONIT STANDARD	€1.676158	€1.7222
ÇMIMI I AKSIONIT KONSERVATIV	€2.007017	--
MJETET NËN MENAXHIM	€2,353,174,911	€2,353,174,908
NUMRI I LLOGARIVE GJITHSEJ	769,839	752,523
NUMRI I LLOGARIVE AKTIVE	317,803	419,654
TARIFA INVESTUESE PËR TREMUJORIN	€1,824,966	€1,886,646
TARIFA OPERACIONALE PËR TREMUJORIN	€325,072	€376,637
INVESTIMET NË KOSOVË	€597,122,424	€536,279,867
INVESTIMET JASHTË	€1,732,712,669	€1,808,309,791
TË PAINVESTUARA (NË BQK)	€4,903,847	€9,313,041

## PLASMANET DHE PERFORMANCA NË FUND TË TMI 2022

MENAXHUESI   FONDI	NUMRI ISIN / LLOJI INVESTIMIT	PLASMANET FUNDI I TMI 2022	KTHIMI BRUTO NË INVESTIME
Vanguard GSIF	IE00B03HD316	€22,525,228.11	€(835,118.99)
Nordea 1-SRF	LU0539147214	€347,269,682.48	€(12,544,263.79)
Nordea 1-GSEF	LU0257969260	€117,299,838.04	€3,488,461.65
BNY Mellon RRF	IE00B504KX99	€298,562,512.66	€(19,085,894.14)
AXA GILB	LU0227145629	--	€(393,667.12)
Amundi Euro Liquidity-Rated SRI	FRO007038138	€131,703,526.90	€(332,674.18)
BNP Parvest DD	LU0102035119	--	€(3,354,516.04)
iShares Edge S&P 500 MinVol	IE00BYX8XD24	--	€(1,043,652.58)
iShares Edge MSCI Europe	IE00B86MWN23	--	€(1,370,154.18)
Invesco QQQ UCITS	US46090E1038	€105,815,359.27	€5,479,792.06
Amundi MSCI Eu Qual Fact	LU1681041890	--	€(4,513,952.16)
SP OilGas Expl ETF	US91232N2071	€26,605,242.40	€6,778,432.21
FirstT CybrSec ETF	US33734X8469	--	€(3,307,826.71)
L&G E-commerce and Logistics	IE00BFOM6N54	--	€(3,408,586.84)
US Infrastructure Dev ETF	US37954Y6730	€46,281,330.31	€299,646.84
US Infrastructure ETF	US46435U7138	€46,472,344.13	€2,245,399.74
Real Estate US ETF	US9229085538	--	€(5,745,839.50)
Pacer Industrial Real Estate	US69374H7668	--	€(5,281,034.44)
Invesco DB Base Metals ETF	US46140H7008	€54,705,290.33	€8,991,183.30
iShares Global Clean Energy ETF	US4642882249	--	€(1,492,987.24)
First Trust Green Energy Fund	US33733E5006	--	€(4,554,510.88)
Schroder ISF Global Sustainable Growth	LU2305367323	€1,674,729.04	€(2,276,639.20)
BNP Climate Impact	LU0406802768	€2,546,406.97	€(2,748,206.62)
AXA WF - Framlington Digital Economy	LU1694772994	€2,426,381.53	€(3,581,366.59)
T. Rowe - Global Technology Equity	LU1244139827	€1,973,440.96	€(5,277,489.75)
Amundi Global Disruptive	LU1530899811	€2,475,798.15	€(3,650,879.96)
Goldman Sachs Global Millennials	LU1820776075	€1,357,009.54	€(4,829,097.31)
Lyxor US\$ 10Y Inflation Expectations ETF	LU1390062831	€87,922,548.00	€5,566,059.74
Lyxor EUR 2-10Y Inflation Expectations ETF	LU1390062245	€59,999,667.14	€3,042,938.14
Vanguard Value ETF	US9229087443	€86,125,681.92	€3,775,553.57
Invesco KBW Bank ETF	US46138E6288	€80,116,175.02	€(4,032,101.11)
iShares Edge MSCI Europe Val. Factor ETF	IE00BQN1K901	€81,814,960.75	€(2,452,435.05)
Lyxor EURO STOXX Banks ETF	LU1829219390	€72,581,475.90	€(12,463,990.37)
SPDR S&P Oil & Gas Explor. & Prod. ETF	US78468R5569	€54,458,039.58	€4,446,330.38
Thesari i Kosovës <sup>1)</sup>	Letra me vlerë të Qeverisë	€542,491,039.43	€2,843,050.64
Banka në Kosovë <sup>1)</sup>	Depozita bankare	€54,631,384.55	€194,189.96
BQK - të gatshme	Të painvestuara	€4,903,847.34	€(34,076.24)
Të hyra të tjera	--	--	€963,586.92
<b>GJITHSEJ</b>		<b>€2,334,738,940.45</b>	<b>€(60,496,335.84)</b>

<sup>1)</sup> Këto janë investime me afat të caktuar maturimi.

## LAJME

<p><b>PASQYRAT E TRUSTIT TANI ME KOD DIGJITAL TË VERIFIKIMIT</b></p>	<p>Me qëllim të lehtësisë së verifikimit të pasqyrave të llogarive në FKPK, prej 1 prillit 2022 të gjitha pasqyrat e gjeneruara nga FKPK-ja do ta kenë në to të paraqitur edhe kodin digjital (QR Code). Përmes këtij kodi çdo pasqyrë mund të verifikohet nga një telefon i mençur ose pajisje e dedikuar për skanimin e kodeve të tilla digjitale.</p> <p>Kështu kontribuuesit do ta kenë shumë të lehtë të konfirmojnë kudo vërtetësinë e pasqyrave të llogarive, pa pasur nevojë që ato të jenë të vulosura.</p>
<p><b>FKPK NË TAKIM INFORMUES ME DREJTUESIT E BQK-SË</b></p>	<p>Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), z. Fehmi Mehmeti, priti në takim përfaqësuesit e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), përkatësisht Kryesuesin e Bordit Drejtues, z. Ruzhdi Morina, dhe Drejtorin Menaxhues, z. Adrian Zalli.</p> <p>Temë kryesore e takimit ishte informimi i drejtuesve të BQK-së me gjendjen e aktuale të investimeve të FKPK-së në tregjet financiare pas ngjarjeve të fundit në Ukrainë.</p> <p>Z. Morina njoftoi se pas vitit 2021, kur investimet e FKPK-së kishin ngritje me rreth 11%, në këtë fillimvit, si për shkak të efekteve negative të pandemisë në zinxhirin furnizues, por sidomos nga lufta në Ukrainë, investimet e FKPK-së kanë njohur një rënie, që aktualisht është rreth 4%. Duke qenë se indekset kryesore në tregjet financiare aktualisht kanë shënuar rënie prej 15% deri në 20%, rënia prej 4% në investimet e FKPK-së mund të konsiderohet mjaft e përmbajtur. Kjo kryesisht si rezultat i masave mbrojtëse që Bordi Drejtues i ka marrë gjatë janarit dhe shkurtit të këtij viti.</p> <p>Po ashtu, me këtë rast, z. Morina e njoftoi Guvernatorin Mehmeti me masën e dytë që Bordi Drejtues e ka vendosur, duke e lansuar Portofolin Konservativ për kontribuuesit e moshës 63.5 vjeçare e më të moshuar. Sipas kësaj mase, mjetet e tyre do të përlllogariten të investuara në Bonot e Thesarit të Republikës së Kosovës dhe asnjë kontribuues 18 muaj e më pak afër pensionimit nuk do të preket nga lëvizjet e tregjeve financiare.</p> <p>Z. Mehmeti, në anën tjetër, pasi i falënderoi për informimin, i vlerësoi përpjekjet e Bordit Drejtues të FKPK-së për masat e ndërmarra, të cilat e kanë ulur rrezikun dhe ndikimin e këtyre lëvizjeve të kontribuuesit. Guvernatori theksoi nevojën e takimeve të rregullta mes të dyja institucioneve, në mënyrë që situata të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme dhe që të sigurohet reagimi i duhur institucional në shërbim të mbrojtjes së interesave të kontributdhënësve.</p>
<p><b>FKPK-JA IMPLEMENTON PORTOFOLIN SIPAS GRUPMOSHAVE</b></p>	<p>Bordi Drejtues i FKPK-së, bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e caktuara me Ligjin mbi Fondet Pensionale dhe në kuadër të strategjisë investuese për mjetet pensionale, në mbledhjen e fundit të muajit shkurt 2022, me qëllim të uljes së luftatshmërisë për kontribuuesit më afër pensionimit, ka shqyrtuar dhe vendosur për funksionalizimin e një portofoli investues shtesë, për personat që janë 18 muaj para moshës së pensionimit. Në kuadër të vendimmarrjes për implementimin e ndarjes së kontribuuesve në grupmosha, Bordi Drejtues mori parasysh edhe lëvizjet e fundit në tregjet financiare, situatën jo të qëndrueshme gjeopolitike, por edhe kthimet pozitive nga investimet përgjatë viteve të mëhershme.</p> <p>Duhet theksuar se krijimi i disa planeve investuese është një risi në sistemin tonë pensional dhe si i tillë është në shërbim të kontribuuesve si mekanizëm mbrojtës. Ndarja e kontribuuesve sipas moshës mundëson që në portofolin bazë (ku do të bëjnë pjesë kontribuuesit më të rinj në moshë) të ketë një strategji investuese me risk dhe kthim potencial në investim më të lartë, pasi mosha e tyre e lejon një qasje të tillë. Ndërsa për planin e sapokrijuar (për kontribuuesit afër pensionimit) investimet do të jenë më konservative, ku synim primar është siguria dhe ruajtja e fitimeve të akumuluar përgjatë viteve. Më konkretisht vendimi është që, në baza mujore, kontribuuesit që e arrijnë moshën 63.5 vjeçare (apo 18 muaj para moshës së pensionimit) të barten në portofolin investuese të posaçëm i cili në përbërje do të ketë kryesisht Bono të Thesarit të Kosovës (mbi 90%), të cilat ofrojnë kthim konstant në investime pa oscilime të theksuara.</p>

**PUBLIKON:**  
Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës  
Prill 2022

**AUTOR**  
Jeton Demi

**FOTO E BALLINËS**  
Bogë e Rugovës - kortezi e autorit Metush Mëziu

**ADRESA**  
Rr. "Agim Ramadani" #182-184 10000 Prishtinë, Kosovë

**E-MAIL & UEB**  
[info@trusti.org](mailto:info@trusti.org) | [www.trusti.org](http://www.trusti.org)

**Facebook:**  
TrustiPensional

**Youtube:**  
Fondi Pensional i Kosovës